

PERIUDHA PAS LINDJES

Të nderuar!

Për t'ju lehtësuar periudhën pas operacionit, ne kemi përgatitur disa informacione dhe rekomandime për ju.

Pas çdo ndërhyrjeje kirurgjikale në zgavrën e mitrës përmes vaginës, mund të shfaqen komplikacione, si p.sh.

- hemorragji më e rëndë se menstruacionet që nuk ndalon,
- sekrecione me erë të keqe,
- temperaturë e ngritur e trupit mbi 38 gradë,
- dhimbje që nuk largohet pas marrjes së një analgjeziku.

Në rast dhimbjeje, merrni barna kundër dhimbjeve. Nëse ndodhin komplikacione, bëni një vizitë me mjekun personal ose gjinekologun tuaj të zgjedhur; në raste EMERGJENCE, ejani në Repartin e Obstetri-Gjinekologjisë.

Rregullojeni raportin mjekësor me mjekun tuaj personal.

Nëse keni bërë një ndërhyrje përmes murit të barkut dhe fijet e qepjes janë hequr në spital, plaga është shëruar dhe mund të lihet e hapur. Nëse keni ende fije të qepjes pas operacionit, ato do të hiqen nga mjeku i zgjedhur personal. Pas operacionit përmes vaginës, fijet bien vetë. Mund t'i shihni ato në pecetën higjienike.

Rrjedhjet vaginale mund të shfaqen ende tre deri në katër javë pas operacionit, por nuk duhet të kenë erë të pakëndshme. Hemorragjia që është më e rëndë se një periode dhe nuk ndalet nuk është normale.

Ju këshillojmë që në shtëpi të ndiqni rekomandimet e mëposhtme:

- Kujdesuni rregullisht për higjenën intime me ujë të rrjedhshëm. Përdorimi i sapunit me pH 5,5 duhet të jetë i moderuar.
- Pas operacionit, nuk rekomandojmë larjet në vaskë, në pishinë apo në det për tre javë.
- Nuk këshillohen marrëdhëniet seksuale deri në një kontroll te një gjinekolog i përzgjedhur, që është katër deri në gjashtë javë pas procedurës, pas regjistrimit paraprak.
- Konsumoni ushqim lehtësisht të tretshëm, që nuk shkakton fryrje, të pasur me vitamina dhe minerale. Filloni të hani fruta të freskëta gradualisht.
- Kryeni defekim të rregullt, pini ujë mineral Donat Mg nëse keni probleme me kapsllëkun.
- Për të paktën gjashtë javë pas operacionit, shmangni sforcimet e rënda fizike dhe ngritjen e peshave të rënda (rekomandojmë deri në 5 kg). Mund të bëni punë më të lehta të përditshme të shtëpisë. Filloni aktivitetin fizik gradualisht.

KRAHAS REKOMANDIMEVE TË MËSIPËRME, NDIQNI GJITHMONË REKOMANDIMET E MJEKUT TUJ EKZAMINUES!

Ju urojmë shërim të shpejtë!

Reparti i Obstetri-Gjinekologjisë
Kodi i katalogut: GPGO-16
Prill 2024, versioni 1